



Prof. Assoc. Dr. Mirela P. BOGDANI është zgjedhur anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Vendimin Nr. 23/2022 të Kuvendit të Shqipërisë, nga trupa e pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës, sipas Ligjit Nr. 115/2016 'Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë, propozuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universitetit të Tiranës në vitin 2000 dhe më pas ka ndjekur të gjitha programet e kualifikimit akademik pranë këtij institucioni. Ky formim përfshin programin e Masterit Shkencor në të Drejtë Publike (2003), Masterin Profesional të në Drejtë Biznesi (2009), Doktoraturën në fushën e administrimit të zgjedhjeve (2011) dhe titullin Profesor i Asociuar (2013). Formimi akademik përfshin gjithashtu studime të thelluara pasuniversitare dhe specializime në fushat e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e investimeve publike në Universitetin e Queen Mary, Qendra për Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar – Londër BM (2005) dhe në fushën e shkrimit & arsytimit ligjor në American University, Washington College of Law – SHBA (2008-2009).

Gjatë karrierës profesionale, ka ushtruar detyrën e profesorit të së drejtës në Departamentin e së Drejtës Publike që nga Nëntori i vitit 2000 e në vijim, në lëndët 'Institucionet politike dhe juridike', 'Shkrimi dhe Arsytimi Ligjor, si dhe 'Politika e Jashtme e BE', në programet Bachelor, Master, programin e doktoraturës, dhe aktualisht në programin e integruar Master i Shkencave në Drejtësi dhe Master Ekzekutiv. Nga viti 2019-2022 ka mbajtur detyrën e Kryetarit të Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore 'Doktor' në Fakultetin e Drejtësisë, dhe nga viti 2020-2022 anëtare e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës.

Nga viti 2012 e në vijim është angazhuar nga Shkolla e Magjistraturës në **Programin e Trajnimit Fillestar** në lëndën Klinika Ligjore, si mentore (*specialiste*) shkencore, që së bashku me grupin e mentorëve drejtojnë magjistratët në hartimin e Memorandumeve Ligjore (*opinioneve ligjore*) *pro bono* për institucionet e larta të drejtësisë si Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Prokuroria e Përgjithshme, Gjykatat Administrative, etj., për çështje që ata kanë interes në punën e tyre të përditshme, duke pasqyruar kërkimin ligjor më profesional të thelluar në praktikën kombëtare, si dhe standardet, praktikat dhe zhvillimet më të fundit ndërkombëtare. Këto Memorandume u dërgohen institucioneve përkatëse dhe botohen në Revistën 'Jeta Juridike' e Shkollës së Magjistraturës që aksesohen më pas nga të gjithë profesionistët e së drejtës. Nga viti 2012 e në vijim, është angazhuar në **Programin e Trajnimit Vazhdues** në trajnime që lidhen me Shkrimin dhe Arsytimin e Vendimeve Gjyqësore, në Eficencën e Drejtësisë - kryesisht e lidhur kjo me mekanizmat e CEPEJ për cilësinë e drejtësisë dhe menaxhimin e kohës gjyqësore dhe Lirinë e Shprehjes.

Në eksperimentin profesional, listohen gjithashtu angazhime në projekte të asistencës ndërkombëtare të donatorëve si USAID, Këshilli i Evropës, BE, OSCE, etj., që lidhen me reformimin e sistemit gjyqësor, rritjen e efikasitetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë së tij, me shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes dhe mediave, çështjet antikorupsion, draftim legjislativ, etj., shoqëruar me botimet dhe publikimet përkatëse. Që nga viti 2012 e në vijim është pika e kontaktit për Programin HELP të Këshillit të Evropës – Human Rights Education for Legal Professionals/Edukimi Ligjor I Profesionistëve të së Drejtës dhe nga viti 2021 anëtare e Bordit Këshillimor të HELP me një mandat 2 vjeçar.